



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:099028
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05556935

Ac.nr.7682/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit A. Sh. nga fshati Ll., Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A. M. avokate nga Peja, kundër të paditurit F. (M.) K. nga fshati Ll, Komuna e Pejës, për shkak të pengim posedimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.732/2022 i datës 26.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN të pathemeltë ankesa e paditësit F. (M.) K. nga fshati Ll., Komuna e Pejës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.732/2022 i datës 26.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.732/2022 i datës 26.09.2023, ka vendosur si në vijim: I.APROVOHET-kërkesëpadia e paditësit A. (M.) Sh., ashtu që VËRTETOHET se i padituri F. K. që nga muaji Prill i vitit 2022 e më tutje fillimisht me vendosjen e pengesave në rrugës në mes të ngastrës-3 ZK. Ll..., siç janë drunjtë dhe zhavorr e me vonë edhe me kundërshtimin për shfrytëzimin e rrugës e cila kalon në ngastrën kadastrale e cila shtrihet përgjatë tërë anës veriore të parcelës-1 në distancë prej 1....cm në drejtim lindje-perëndim në gjerësi prej 5..... cm, drejtim veri-jug me gjatësi4 cm, ana jugore drejtim lindje-perëndim si dhe pika 4 deri 1 në gjerësi 3.... cm, ana perëndimore drejtim jug-verim, ashtu që DETYROHET i padituri të i heq pengesat dhe të ja mundësoj kalimin - shfrytëzimin e rrugës për hyrje në

patundshmërinë e tij dhe të obligohet në të ardhmen nga përmbajtja e çdo veprimi që dërgon në pengim posedim. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi i padituri, në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta anulojë dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimit e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A. Sh. nga fshati Ll., Komuna e Pejës, në gjykatën e shkallës së parë, me datë 18.05.2022 ka parashtruar padi kundër të paditurit F. (M.) K. nga fshati Ll., Komuna e Pejës, për shkak të pengim posedimit.

Gjykata e shkallës sëparë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave ka nxjerrë aktvendimin C.nr.732/2022 i datës 26.09.2023, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditësit, duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka arsyetuar se: Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, pas administrimit të gjitha provave dhe vlerësimit të tyre, secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku e në lidhmëri me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 480 të LPK-së, e lidhur me nenin 103, 110, 111 dhe 113 të LPDTS, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për faktin se nga provat e administruara u vërtetuar se paditësit është penguar në ngastrën e cila është objekt kontesti, dhe atë u vërtetuar se *kush, kur dhe në ç'mënyrë* është kryer akti i pengim posedimit.

Më tej ka shtuar se Me nenin 103 të LPDTS është paraparë se personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë. Ndërsa me nenin 104 të njëjtit ligj është paraparë se posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes. Me nenin 111 të LPDTS është paraparë se personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj. Me nenin 113, par. 1 dhe 2 të LPDTS është paraparë se nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Dhe nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë

të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore. Me nenin 480 i LPK-së është paraparë se shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfshihet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërjegjeshmerinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit.

Më tej ka shtuar se>Se kjo rrugë e cila gjendet në ngastrën kadastrale .../3 është përdoruar si rrugë kalimi nga të gjithë bashkëpronarët ky fakt vërtetohet nga vetë certifikata e pronës e datës 01.03.2023, në të cilën përcaktohet “*Shfrytëzimi aktual i parcelës*” e që është “Rrugë”, po ashtu edhe nga deklarimi i dëshmitarit A. K. i cili kishte deklaruar se para shtijës së kësaj parcele asnjëherë më herët nuk kemi pasur pengim në posedim, dhe gjithmonë e kemi shfrytëzuar atë tokë pa e penguar nga askush. Gjykata po ashtu si pjesë më të mbështetshme në prova materiale dhe më relevante për çështjen nga deklarimi i dëshmitarit A.. K. vlerësoi pjesët ku dëshmitari deklaroi se “*Personi që ka kaluar andej ka qenë nipi i A...*” nga e cila vërtetohet se paditësit me të vërtetë e kishte në shfrytëzim këtë rrugë pasi që për të nënkuptuar posedimin e një të drejte nuk është e domosdoshme që gjithsesi ta kesh në posedim fizik mirëpo posedimi mund të shtrihet edhe në mënyrë të tërthortë e që në rastin konkret pra paditësi i kishte lëshuar me qira tokën e tij nipit të tij, e i cili e kishte shfrytëzuar atë rrugë. Po ashtu se paditësi e ka shfrytëzuar këtë rrugë vërtetohet edhe nga deklarimi tjetër dëshmitarit të lartcekur A. K. i cili ka deklaruar se “*kërkesa e A.. ka qenë që të shtrohen vetëm dy kolica zhavorr pasi që A. po i prek vetura në tokë për shkak të gropave në rrugë...*” ku i referohet gropave që gjendet në rrugën kontestuese, e nga ky citim qartë kuptohet se paditësi për të u qasur në pronat e tij që janë fqinje me ngastrën që është objekt kontesti, pra e ka shfrytëzuar këtë rrugë. E se kjo parcelë është rrugë kalimi më së miri vërtetohet edhe nga vetë dalja e gjykatës në vend shikimin ku në shikim të lirë vërehen gjurmët e krijuara nga kalimi i automjeteve dhe nga vetë deklarimi i të paditurit në përgjigje në padi i cili kishte deklaruar se “*Këtë e pranoj se është rrugë kalimi*”.

Më tej ka shtuar se: Se pengimi ishte bërë nga ana e paditësit duke vendosur drunjtë dhe zhavorr në mes të rrugës e cila gjendet në ngastrën 136-3, kjo vërehet nga dy fotot të cilat gjenden në shkresat e lëndës ku në mënyrë të qartë shihen pengesat e vendosura në mes të rrugës, se këto pengesa ishin të vendosura po në këtë rrugë identifikimi i tyre u bë edhe nga eksperti gjeodet pasi që kishte konstatuar se në bazë të fotografive pengim posedimi i pretenduar është kryer në mesin e kësaj rruge, ku pengesat e vendosura që shihen në fotografi përkonin me rrugën kur gjykata me ekspertë ishin dalë për të bërë identifikimin e asaj pjese.

Më tej ka shtuar se: Gjykata me rastin e vendosjes e ka shqyrtuar edhe pretendimet e të paditurit, mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara dhe në kundërshtim me provat të cilat gjykata i kishte vërtetuar në këtë çështje. Gjykata vlerëson se i padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit në shenjë hatër mbetjes për shkak se djem e axhës e kishin shitur patundshmërinë e tyre tek paditësi A. Sh. i cili nuk i përket fisit të tyre. Në kundërshtim me rregullat e traditës së vendit, ku në radhë të parë sipas paditësit është dashur që të ftohen të afërmit në vijë gjaku e pastaj të kalohet në persona jashtë fisit nëse nuk paraqiten blerës të interesuar. Mirëpo, ky pretendim i të paditurit është i pa bazuar në dispozitat ligjore të aplikueshme në vendin tonë, ku e drejta e parablerjes

është e siguruar vetëm në dy raste dhe atë tek bashkëpronësia dhe kur kjo e drejtë është e kontraktuar.

Më tej ka shtuar se: Edhe pretendimi tjetër i të paditurit se në pjesën veriore të ngastrës ...-1 ZK. Ll.. paditësi nuk mund të kaloj sepse ajo është pronë e familjes tonë, respektivisht babait të paditurit (M. K.) është i pa qëndrueshëm. Kjo për faktin se ajo pjesë e ngastrës është me kulturë rrugë, e cila është shfrytëzuar nga disa familje që jetojnë aty, e po ashtu edhe nga paraardhësi juridik i paditësit i cili e ka shfrytëzuar si rrugë për tu inkuadruar në rrugën kryesore të fshatit. Pra, fakti pse ajo evidentohet formalisht në emër të babait të paditurit nuk nënkupton se duhet të privohen të tjerët nga shfrytëzimi i saj si rrugë. Sepse si e tillë ajo është shfrytëzuar shumë me parë, pra ka qenë e themeluar si rrugë. Kjo do të ishte jo logjike sepse edhe paditësi A. Sh. është i evidentuar si bashkëpronarë me ¼ pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr. .../3 ZK. Ll., me kulturë rrugë. Dhe do të ishte në kundërshtim të dispozitat ligjore në çoftë se ai të paditurit F. dhe familjes së tij, t'ia pamundësonte kalimin nëpër te, për të shkuar në tokat e tyre. Andaj, edhe ky pretendim i të paditurit është i pabazuar në ligj, për çka gjykata e ka urdhëruar të njëjtin që mos ta pengoj në të ardhmen paditësin në shfrytëzimin e kësaj rruge.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të nenit 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, përfundim e Gjykatës së shkallës së parë në tërësi e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, për të cilat gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e as në shkeljet në të cilat thirret pala me ankesë, e gjithashtu është vërtetimit të drejtë dhe të plotë edhe gjendja faktike.

Gjykata e Apelit nuk i pranon pretendimet ankimore të paditësit se aktvendimi i ankimuar është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore. Dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është i qartë i kuptueshëm dhe nuk është kundërthënës me arsyet e tij. Po ashtu aktvendimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, në të janë dhënë arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre, pasi që në kontestet e pengimit të posedimit gjykata është e obliguar të provoj faktet lidhur me gjendjen e fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara është vërtetuar se paditësi është posedues i fundit i ngastrës lëndore dhe është vërtetuar akti i pengim posedimit në ngastrën lëndore, në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të paditurit në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila gjendje faktike i rezulton e njëjtë edhe gjykatës së Apelit, pasi që nga provat që gjinden në shkresat e lëndës është vërtetuar akti i pengim posedimit, ku i padituri me datë 25.04.2022 e tutje, fillimisht me vendosjen e pengesave në rrugës në mes të ngastrës-3 ZK. Ll..., siç janë drunjte dhe zhavorr e me vonë edhe me kundërshtimin për shfrytëzimin e rrugës e cila kalon në ngastrën kadastrale e cila shtrihet përgjatë tërë anës veriore të parcelës-1 në distancë prej 14..... cm., në drejtim lindje-perëndim në gjerësi prej 5..... cm., drejtim veri-jug me gjatësi74 cm., ana jugore drejtim lindje-perëndim si dhe pika 4 deri 1 në gjerësi 3.... cm., ana perëndimore drejtim jug-verim, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të plotë nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore. Andaj, këto veprime të ndërmarrura nga i padituri janë pengesë që paditësi të posedoj në mënyrë të lirë dhe të qetë paluajtshmërit në fjalë, pasi që veprimet e të paditurit kanë qenë arbitrare dhe jo të bazuara në dispozita ligjore dhe kanë penguar paditësin në shfrytëzimin e parcelës kontestuese, fakti se i padituri nuk është i pajtimit me blerjen e parcelës kontestuese nga paditësi, të njëjtit nuk i jepet e drejta që të ndërmerr veprimet e cekura si më lartë, të cilat veprime i kanë pamundësuar paditësit shfrytëzimin e qet dhe të lirë të ngastrës kontestuese.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur në bazë të detyrës zyrtare, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është mbështetur në nenin 113 të LPTDS/ Ligji nr. 03/ L-154 25 qershor 2009/ ku përcaktohet se “ Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore. Kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit.”, ndërsa sipas nenit 480 të LPK-së, i cili parasheh që “Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit”. Sipas nenit 103 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, përcakton se: “Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”. Ndërsa me nenin 104 të njëjtit ligj është paraparë se “posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes”. Sipas dispozitës së nenit 111 paragrafi 1 të LPDTS parashihet se: “Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj”. Andaj, i padituri me veprimet e tij ka shkaktuar aktin e pengim posedimit duke vendosur drunjtë dhe zhavorr në mes të rrugës e cila gjendet në ngastrën-3, veprime këto të cilët i kanë pamundësuar paditësit që të shfrytëzojë në mënyrë të qetë dhe të lirë paluajtshmërinë kontestuese e të cilat veprime janë të pa

pranueshme, pasi që i padituri të gjitha mosmarrëveshjet me paditësin në lidhje me çështjet kontestuese duhet ti zgjedhë në mënyrë ligjore dhe jo të ndërmer veprime arbitrare për të pamundësuar paditësin në kalimin në rrugën e cila është objekt kontesti përmes së cilës edhe është penguar në shfrytëzimin e qetë dhe të lirë të ngastrës kadastrale.

Në rrethana të tilla rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar faktet që kanë të bëjnë me gjendjen e fundit të posedimit dhe pretendimit për aktin e posedimit, ku mbi këtë bazë nga provat e administruara ka nxjerr përfundimin e drejtë se paditësi është penguar nga i padituri në posedimin e lirë dhe të qetë të ngastrës lëndore, prandaj edhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit i vlerësoj edhe pretendimet tjera të të paditurit të parashtruara në ankesë, por të njëjtat nuk u morën për bazë, pasi që nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e paditësit, pasi që të njëjtat nuk kishin relevancë në këtë çështje kontestimore, pasi që gjykata në rastet e pengimit të posedimit është e lidhur vetëm me posedimin e fundit dhe jo me të drejtat që pretendojnë palët në lidhje me parcelat kontestuese.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7682/2023, me datë 08.04.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v